



Datë: 02.06.2025
Numër Protokolli: 3749/2025

A.nr.646/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.646/2025, të datës 14.04.2025, të parashtruar nga ankuesja S.B., kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen administrative-juridike “*Kompensim Material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.646/2025 e datës 14.04.2025, e parashtruar nga ankuesja S.B.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, S.B.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 14.04.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli 2449/2025, nën shenjë A.nr.646/2025, kundër njoftimit të datës 21.03.2025, të Menaxherit të Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa me datë 08.05.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2449/2025 të datës 14.04.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 20.02.2020; Akt emërimit AE.Nr.180/2023 të datës 01.09.2023; Certifikatën e vdekjes, me Nr.V60029342 të datës 21.03.2025;

Certifikatën e lindjes, me Nr.L60737118 të datës 26.03.2025; Dokument identifikimi; E-mailat e datës 21.03.2023; Kërkesën dhe përgjigjen në ankesë të datës 08.05.2025.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstatoi se ankuesja sipas Akt emërimit AE.Nr.180/2023 të datës 01.09.2023, është e punësuar në pozitën e punës “Zyrtare për Trajtimin e të Burgosurve dhe Çështje Sociale” në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Si rrjedhojë, ankuesja më datë 21.03.2025 ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Shërbimit Korrektues të Kosovës, me pretendimin për kompensimin e një page shtesë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (nënës), duke ofruar si dëshmi certifikatën e lindjes së datës Certifikatën e lindjes, me Nr.L60737118 të datës 26.03.2025 si dhe Certifikatën e vdekjes, me Nr.V60029342 të datës 21.03.2025, me të cilin dëshmohet se anëtari I ngushtë I familjes (Nëna) i ka ndërruar jetë me datë 23.03.2023.

Ndërsa, Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes emailit të datës 21.03.2025, ka refuzuar kërkesën e ankueses për një pagë shtesë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, për shkak të ndryshimit të legjislacionit përkatës që rregullon këtë çështje, gjegjësisht se Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk parasheh ndonjë lloj pagese apo kompensimi me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Ankuesja, ankesën e ka parashtruar në Këshill, për shkak të shkeljeve esenciale procedurale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ashtu që kërkon anulimin e njoftimit të lartë theksuar, aprovimin e ankesës dhe detyrimin që Menaxheri I Burimeve Njerëzore pranë ShKK-së, të njohë të drejtën dhe të ekzekutojë shumën e një page prej 616.00 Euro.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses, thekson faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023 dhe si rrjedhojë sipas nenit 45 paragrafi 1 dhe 2, ka përcaktuar se: “1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil; 2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t’u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji”, rrjedhimisht me krijimin e këtyre rrethanave të reja ligjore ky nen ka shfuqizuar ligjin paraprak të pagave, Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime tjera të Nëpunësve Civil si dhe po ashtu bazën ligjore mbi të cilën ankuesja mbështet pretendimin e saj, gjegjësisht nenin 29 paragrafin 1.3 i të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, i cili ka përcaktuar të drejtën në shtesë të një page bazë në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Andaj, duke qenë se me Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk parashihet një kompensim i kësaj natyre, dhe se sipas nenit 45 paragrafit 2 është shfuqizuar çdo dispozitë e ligjit apo e aktit tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave etj, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimi ankimor i ankueses është i pa qëndrueshëm, ndërsa Menaxheri i Personelit i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me të drejtë dhe duke vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi ka refuzuar kërkesën e ankueses.

Nga ajo që u tha si më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.646/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses S.B.;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.